



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 510 Prot.

Tiranë, më 21.01.2025

URDHËR

Nr. 34, Datë 21.01.2025

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 365, DATË 28.12.2020 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PROVIMIT TË SHTETIT DHE PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË PROVIMIT TË SHTETIT”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 10, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA)”, i ndryshuar, vendimit nr. 560, datë 29.9.2018 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar dhe urdhrin nr. 113, datë 26.3.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në rregulloren bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e urdhrin nr. 365, datë 28.12.2020 “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit”, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

a) Pika 7 e nenit 13 ndryshon si më poshtë:

*“7. Kandidati bën aplikimin nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, duke ngarkuar dokumentet e mëposhtme:*

a) *diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin/profilin respektiv; (vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rastet kur studimet janë përfunduar jashtë shtetit);*

- b) dokumentacionin e lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlershëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur;
- c) dokumentin që vërteton e vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuar.”

b) Pas pikës 7 shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

*“7/1 Dëshmia e pjesëmarrjes në praktikën profesionale të lëshuar nga UP-ja ose në mungesë të UP-së, nga institucioni kompetent për kryerjen e praktikës, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja, sigurohet me ndërveprim nga struktura përgjegjëse respektive”.*

c) Pika 1 e nenit 24 ndryshon si më poshtë:

*“1. Kandidati ka të drejtë të verifikojë përgjigjet e dhëna dhe të ankimojë rezultatin në portalin unik qeveritar “e-Albania”, në shërbimin “Vërtetim për rezultatin e provimit të shtetit”, nëse ka kontestime për të. Kandidati ngarkon ankesën brenda 10 ditëve nga shpallja e rezultatit të provimit të shtetit.”.*

d) Pika 1 e nenit 29 ndryshon si më poshtë:

*“1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij urdhri, në kohën e paraqitjes së tyre.”.*

- 2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Komisionet e Provimeve të Shtetit, autoritetet kompetente dhe urdhrat profesionalë përkatës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

